



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 23.05.2023

Nr: 128

Ora: 13:35

VENDIM

PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 73, DATË 22.05.2023 TË DEPOZITUAR NGA "PARTIA ALEANCA DEMOKRISTIANE E SHQIPËRISË"

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 23.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvin	LAKO	-	Relator
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: "Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë", përfaqësuar nga z. Zef Bushati

OBJEKT:

- Kundërshtim i vendimit nr. 196, datë 18.05.2023 të KZAZ nr. 80, Gjirokastër "Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e këshillit të bashkisë Gjirokastër"
- Rinumërim dhe rivlerësim i votave të vlefshme dhe të pavlefshme në kutitë e votimit për këshillin për QV 4242, 4262 dhe 4310.



3. Ndryshimin e tabelës për rezultatin për keshillin bashkiak Gjirokastër duke përfshirë në të rezultatin e dalë nga procesi i rinumërimit dhe rivlerësimit të votave.

BAZË LIGJORE: Nenet 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 73 regj., datë 22.05.2023.

Në mbledhjen e datës 23.05.2023, pas relatimit të z. Elvin Lako u konstatua se kërkesa ankimore nr. 73 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126 dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 73, datë 22.05.2023, të paraqitur nga “Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”.
2. Shqyrtimi i kërkesës ankimore do të zhvillohet më datë 24.05.2023, ora 14:00.

3. Ngarkohet administrata e KQZ-së me njoftimin e këtij vendimi palëve në mungesë dhe me zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

Elvin	LAKO	-	Relator
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar